



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

## VENDIM

Denoncimi me numër 12-3800/1 të datës 05.11.2020, me akuzë për shkelje të ligjit në një procedurë për përcaktimin e statusit ligjor të një objekti të ndërtuar në mënyrë të paligjshme dhe në një procedurë për eksproprijimin e tokës së ndërtimit, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja përcaktoi se në përputhje me dispozitat LPKKI-së nuk ka elemente për veprime të metutjeshme për arsye se për rastin konkret ka vepruar një organ tjetër, i cili ka ndërmarrë veprime nga kompetencat e sajë.

Lënda me numër 12-7287/1 të datës 24.12.2021 të mbillet dhe të arkivohet.

Vendimi në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e Komisionit shtetërorë në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e miratimit.

## Arsyetim

Me datë 05.11.2020, nga një parashtrues i njohur është dorëzuar denoncim me pretendime për paligjshmëri në procedurë për përcaktimin e gjendjes juridike të objektit të ndërtuar pa leje dhe procedurë për shpronësim të tokës ndërtimore, dhe është formuar lënda me numër 12-3800/1 të datës 05.11.2020.

Në denoncim, parashtruesi thekson se ka paraqitur kërkesë në Komunën e ----- për përcaktimin e gjendjes juridike të objektit të ndërtuar pa leje me dokumentacion të plotë konform dispozitave të Ligjit për trajtimin e Ndërtesave të ndërtuara pa leje. Kryetari i komunës, përkatësisht komisioni i formuar për atë qëllim, nuk ka vepruar sipas kërkesës së deklaruar, por ka filluar një procedurë tjetër administrative për shpronësim. Në seancën e caktuar publike në Departamentin për Çështje Pronësore dhe Juridike - ----- parashtruesi theksoi kërkesën e paraqitur për përcaktimin e statusit juridik të objektit të ndërtuar pa leje, për të cilën organi i shpronësimit ka nxjerrë Konkluzion për përfundimin e procedurës së shpronësimit deri në përfundimin e procedurës së legalizimit. Përkundër konkluzionit të miratuar, Komuna -----, duke mos respektuar procedurën e përcaktuar në ligjin kompetent, ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për legalizim për arsyt

se ishte planifikuar ndërtimi me interes publik. Paralelisht me këtë procedurë, organi shpronësues ka kryer procedurën për shpronësimin e parcelës në fjalë. parashtruesi thekson se ka përdorur mjete juridike kundër vendimeve të Komunës ----- dhe Departamentit për Çështje Pronësore dhe Juridike -----, d.m.th. ka zhvilluar procedurë para Ministrisë së Transport dhe Lidhje, Gjykata Administrative, Gjykata më e lartë administrative ka paraqitur edhe mjet të jashtëzakonshëm juridik për përsëritjen e të dyja procedurave.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstaton se pretendimet në denoncim nuk tregojnë sjellje të kundërligjshme të zyrtarëve, dhe për shkak se organet tjera kompetente tashmë kanë vepruar në lidhje me pretendimet në rastin në fjalë: Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, Gjykata Administrative, Gjykata e Lartë Administrative, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.M.J

Miratoi: K.N., Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTEETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
Nënkryetar  
**Katica Nikolovska**

